



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2023, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT
1Nr.351-668 TË DATËS 13.10.2008

Neni 1

1.Me këtë Vendim ndryshohet neni 1 i Vendimit 1Nr.351-668 i datës 13.10.2008 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Lipjanit për shpalljen e interesit të përgjithshëm për paluajtshmeritë në ZK Grackë e Vjetër për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit, ashtu që parcelat kadastrale me numrat rendor 1, 2, 3 dhe 4 fshihen ndërsa mbetet vetëm parcela kadastrale me numrin rendor 5, përkatësisht neni 1 riformulohet si vijon:

Me këtë Vendim shpallet interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit në:

Parcelën kadastrale P-71409080-00007-0 me sipërfaqe prej 21715 m² ZK Grackë e Vjetër në pronësi të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar në hyrje të këtij akti, ndërsa qëllimi i miratimit të këtij Vendimi është mundësia e zgjidhjes së qështjes së banimit për kategoritë dalura nga lufta e UÇK-së.

Meqenëse, Vendimi INr.351-668 të datës 13.10.2008 për shpalljen e interesit të përgjithshëm për paluajtshmeritë në ZK Grackë e Vjetër për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e daluara nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit, nuk është zbatuar për shkak se parcelat kadastrale siç janë përcaktuar nga pika 1, 2 dhe 3 të nenit 1 të Vendimit INr.351-668 i datës 13.10.2008, kanë qenë në menaxhim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) dhe tani në bazë të të dhënave nga Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, aktualisht parcelat kadastrale nr.00004-0, nr.00005 dhe nr.00006-0 ZK Grackë e Vjetër janë privatizu dhe kanë kaluar në pronësi private, ndërsa në pikën 4 të nenit 1 të vendimit të lartëcekur parcela kadastrale nr 00008-0 është rrugë e pakategorizur ZK Grackë e Vjetër e cila është në menaxhim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve.

Nga të cekurat më lartë propozojmë që me këtë ndryshim të fshihen parcelat kadastrale të cilat nuk janë në pronësi të Komunës së Lipjanit dhe të mbetet vetëm parcela kadastrale e evidentuar në nenin 1 të këtij vendimi, përkatësisht parcela kadastrale P-71409080-00007-0 me sipërfaqe prej 21715 m² ZK Grackë e Vjetër e cila është në pronësi të Komunës, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm publik siç ceket në dispozitiv të këtij propozim -Vendimi.

Prandaj, mbi këtë bazë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

INr. 463/01-24988
Lipjan, Më 16.05. 2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

1Nr. 351 - 668

Lipjan, me 13. 10. 2008.

Në bazë të nenit 17 pika "c" të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të dates 4 qershor 2008, si dhe nenit 62 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 26. 09. 2008, pas shqyrtimit të propozimit të Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm merr këtë :

VENDIM

PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PËR PALUAJTSHMERITË NË ZK GRACKË E VJETËR PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE BANESORE PËR KATEGORITË E DALUARA NGA LUFTA E UÇK-së NGA KOMUNA E LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim shpallet interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit, në ngastrat kadastrale si vijon:

- 1.nr.njesisë P-71409080-00004-0 kullosë e kl.1 –parë me sipërfaqe prej 4.32,68 ha nga Çertifikata UL-71409080-103 ZK Grackë e Vjetër në emër P.SH.Koperativa bujqësore e Kosovës .
- 2.Ngastra kadastrale nr.njesisë P-71409080-00005-0 pemishtë e kl.2-të me sipërfaqe prej 1.42,56 ha nga Çertifikata UL-71409080-103 ZK Grackë e Vjetër në emër P.SH.Koperativa bujqësore e Kosovës .
- 3.Ngastra kadastrale nr.njesisë P-71409080-00006-0 rrugë e pakategorizuar me sipërfaqe prej 0,32,42 ha nga Çertifikata UL-71409080-103 ZK Grackë e Vjetër në emër P.SH.Koperativa bujqësore e Kosovës .
- 4.Ngastra kadastrale nr.njesisë P-71409080-00008-0 rrugë e pakategorizuar me sipërfaqe prej 1.22,22 ha nga Çertifikata UL-71409080-246 ZK Grackë e Vjetër në emër P.SH.(Lidh.dhe rrugëve Ministrija).
5. Ngastra kadastrale nr.njesisë P-71409080-00007-0 rrugë e pakategorizuar me sipërfaqe prej 2.17,15 ha nga Çertifikata UL-71409080-100 ZK Grackë e Vjetër në emër P.SH. Kuvendi Komunal Lipjan .

Neni 2

~~Këto paluajtshmeri (ngastra kadastrale) shpallen në interes të përgjithshëm për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit .~~

Neni 3

Obligohet Zyra e Kryetarit – Shërbimi pronësoro-juridik i KK Lipjan që pas marrjes së Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ndërmerr të gjitha procedurat administrative deri në perfundim të qështjes.

Neni 4

Pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi, do të detalizohen procedurat tjera në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe Komunës së Lipjanit

Neni 5

Me këtë Vendim obligohet DPUKMM-Spektori për kadastrë dhe gjeodezi të ben rexhistrimin e të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm në emër të KK Lipjan me destinim si në pikën 1 të këtij Vendimi në librat publike të kadastrit dhe gjeodezisë, si dhe të bartet-shenohet edhe në skicat e planeve hartografike po të këtij shërbimi me të gjitha dimensionet të sipërfaqesë së ngastrave.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit .

Neni 7

Me vendim të njoftohet Zyra e Kryetarit – Shërbimi Pronosoro Juridik dhe DPUKMM- Spektori për Kadastrë dhe Gjeodezi, ndërsa një kopje të ruhet në materialin e Kuvendit .

Kryesuesi i Kuvendit
Lulzim Brustemi





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409080-00007-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1836/2023

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

10.05.2023 - 09:09

Komuna / Opština / Municipality:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Grackë E Vjetër / Staro Gracko / Grackë E Vjetër

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409080-00007-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		21715	1-92		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
SHIPKOVÇA POTOK				

A.2 LTOJ I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Poljoprievredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës 3/Njiva 3 Klase/3rd Class Arable Land	21715

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1	1-92	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Grackë e Vjetër

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71409080-00007-0	Parcelë / Parcela / Parcel	21715



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1336

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 10.05.2023

Koha/ Vreme/ Time: 01:16:12

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

